

## PROTOKOLLI PËR VEPRIMIN E SHKOLLAVE TË MESME NGA MATURA SHTETËRORE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

- Në shkollat e mesme ku realizohet matura shtetërore është e nevojshme të sigurohen kushtet sanitare-higjienike.
- Mjetet për dezinfektim të vendosen para shkollës dhe të bëhet dezinfektim i detyrueshëm i duarve të të gjithë nxënësve dhe të gjithë të përfshirëve në realizimin e maturës shtetërore para se të hyjnë në shkollën.
- Gjatë hyrjes në shkollë, të kryhet matja temperatura e çdo nxënësi dhe të gjithë të përfshirët në realizimin e maturës shtetërore, si dhe dezinfektimi i duarve.
- Të gjithë pjesëmarrësit në realizimin e maturës shtetërore (nxënësit, testuesit, vëzhguesit dhe anëtarët e komisioneve shkollore të maturës, rojtarët, pastruesit) detyrimisht të mbajnë maskë mbrojtëse në ditën e provimeve, për tërë kohëzgjatjen e tyre.
- Nxënësit sipas orarit të vërtetuar hyjnë në klasat në periudhën prej ora 9.15 deri në ora 10.00.
- Nxënësit detyrimisht të mbajnë dokument për identifikim personal dhe mjete për të shkruar.
- Të shënohen hyrjet për hyrje dhe dalje nga vendi ku do të mbahet dhënia e provimit, si dhe shtigje për lëvizje njëkahëshe, me shenja të vendosura me të cilën tregohet drejtimi i lëvizjes dhe ruajtje e nevojshme e distancës minimale gjatë pritjes rend të nxënësve para dhe brenda në shkollën.
- Të ketë shërbim të organizuar të rojeve në shkollë, me qëllim zbatimin e rendit dhe mbajtjen e distancës së nevojshme midis nxënësve prej minimum 2 metra para hyrjes dhe brenda në shkollë, edhe atë 2 rojtarë para hyrjes së shkollës dhe 2 rojtarë për shkollën. Rojtarët të angazhohen prej rendit të të punësuarve në shkollë, për të cilën vendos drejtori i shkollës së mesme.
- Të organizohet hapësira në klasat, me qëllim zbatimin e rendit dhe mbajtje të distancës së nevojshme fizike midis nxënësve prej minimum 2 metra me prani në maksimum 15 kandidatësh në një klasë. Detyrimisht të bëhet dezinfektimi i bankave dhe karrigeve në klasat ku do të mbahet provimi i nxënësve, me mjet dezinfektues që ndikon në virusi sipas udhëzimit nga prodhuesi.
- Klasat në të cilën realizohet matura shtetërore, para fillimit të provimeve ajrosen ose përderisa mundësojnë kushtet e motit, lihet dritarja e hapur.
- Pas përfundimit të provimit, nxënësit ta lëshojnë klasën, duke lëvizur pas drejtimeve të shënuara të lëvizjes.
- Mirëmbajtje të rregullt të tualeteve me udhëheqjen e detyrueshme të evidencës për pastrimin e zbatuar dhe përdorimin e mjeteve dezinfektuese të lartshënuara.
- Në fund të çdo dite detyrimisht pastrim dhe dezinfektim mekanik me mjet i cili ndikon mbi viruset sipas udhëzimit të prodhuesit. Në mënyrë alternative mund të shfrytëzohet hipoklorit të natriumit 0,05% (5% zbardhues për amvisëri që shfrytëzohet në raport 1: 100) ose alkool 70% për dezinfektimin e sipërfaqeve të sipërme.
- Përveç këtij Protokolli vlen edhe Protokolli për veprimin e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për realizimin e procesit edukativo-arsimor me prani fizike të nxënësve në

vitin shkollor 2020/2021, me shënim për respektimin e rreptë të masave të parashikuara parandaluese.

- Organizatorët e dhënies së provimit të maturës shtetërore do të mbajnë përgjegjësinë e plotë për kontrollin dhe zbatimin e drejtë të masave të protokollit